

VENDIM
Nr. 204, datë 13.9.2018

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN GUSHT 2018**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 86, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, për muajin gusht 2018,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a. me shkresën nr. 16436 prot., datë 27.8.2018, paraqiti në ERE aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin gusht 2018.

- Informacioni i dërguar në këtë shkresë është përgatitur në mbështetje të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018 mbi rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, pikërisht neni 8, i rishikuar, i “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017.

- Duke u mbështetur në formulën përlllogaritëse të nenit 8, OSHEE sh.a. ka përcaktuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2018 prej 12,86 lekë/kwh.

- Prodhimi i përgjithshëm i prodhuesve me përparësi dhe KESH-it për muajin gusht 2018 ka qenë i mjaftueshëm për të mbuluar kërkesat për klientët fundorë FSHU, për mbulimin e humbjeve dhe për furnizimin e klientëve të FMF-së. Për rrjedhim, kërkesa për klientët e FMF për muajin gusht 2018 është mbuluar nga prodhimi i energjisë nga prodhuesit me përparësi me çmimin 8.5652 lekë/kwh në bazë të vendimit nr. 19, datë 19.1.2018, të Bordit të ERE-s.

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 8814/1, datë 24.5.2018, deklaroi se nuk ka ndarje të llogarive midis aktivitetit të furnizimit dhe shpërndarjes dhe nuk ka një strukturë të posaçme për evidentimin e kostove të administrimit dhe kostot e disbalancave për klientët e FMF-së. Për rrjedhojë, është e arsyeshme që, për sa kohë që nuk ka ndarje të llogarive midis aktiviteteve dhe mungon struktura për evidentimin e kostove për klientët FMF, për përcaktimin e kostove administrative të pranohet si e arsyeshme vlera prej 1,79 lekë/kwh e deklaruar nga OSHEE sh.a.

- Në vijim, me ndarjen administrative/ organizative të OSHEE-së sipas aktiviteteve do të jetë e mundur saktësimi i këtyre kostove dhe axhustimi i tyre për periudhat e mëparshme në përputhje me “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, miratuar me vendimin nr. 210, datë 28.12.2017, “Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2018” është 0.75 lekë/kwh.

- Tarifa e përdorimit të Rrjetit të Shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, miratuar me vendimin nr. 211, datë 28.12.2017 “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a. për tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2018” është 1.5 lekë/kwh.

- Nga verifikimi i informacionit dhe përlllogaritjeve të paraqitura nga shoqëria rezulton se çmimi

për shitjen e energjisë elektrike për klientët në kushtet e FMF-së për muajin gusht 2018 është 12.86 lekë/kwh.

- OSHEE sh.a. nuk ka llogaritur kostot e disbalancave për klientët FMF.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e furnizimit me energji elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 12,86 lekë/kwh për muajin gusht 2018.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti